



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

FUSHA: GJUHËT E HUAJA

LËNDA: ITALISHT

KODI: 3.03

PROGRAMI I LËNDËS ITALISHT PËR KLASËN E 10
(për nxënës fillestarë)

TIRANË, NËNTOR 2008

Mësimi i gjuhëve të huaja ndihmon në mënyrë të veçantë në formimin e përgjithshëm të nxënësit. Ai shton mundësitë shprehëse të tij, e pajis atë me mjetet dhe metodologjinë e përshtatshme komunikative që do t'i shërbejë për t'u ndërfutur në shkëmbime të shumëllojshme, etj.

Programi i gjuhës italiane për klasën X është një dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë përdoruesit e tij (mësues, nxënës e autorë të teksteve).

Programi i gjuhës italiane për klasën X ka për qëllim të arrijë dhe realizojë standardet e mësimdhënies, të nxënies dhe të vlerësimit të nxënësit në nivelin gjuhësor A1, sipas tabelës së vlerësimit në Kuadrin e përgjithshëm evropian për gjuhët.

Programi, për nga struktura dhe organizimi, reflekton sugjerimet e Institutit të Kurrikulës dhe të Trajnimit; ai është mbështetur përgjithësisht në strukturën e parashtruar në *Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar* (1999), si dhe në konceptimin dhe metodologjinë e *Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët*.

Duke qenë se mësimi i një gjuhe është në të njëjtën kohë edhe njohje e kulturës apo kulturave të tjera kjo gjë bën të mundur edhe rritjen e horizontit kulturor dhe formues të nxënësit dhe ndikon drejtpërsëdrejti në formimin e personalitetit të tij. Programi ndërtohet mbi tematikën që lidhet me interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe kontribuon në zhvillimin e pavarur, intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit.

Programi i gjuhës italiane për klasën X ka si synim zhvillimin gjuhësor, intelektual dhe kulturor të nxënësit në mënyrë që ai të jetë i aftë të përballojë të nxënët gjatë gjithë jetës.

Ai synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe pavarësinë e nxënësit në kontekstin e klasës dhe jashtë saj, duke nxitur forma të ndryshme të punës individuale dhe të ndërveprimit në çifte e grupe.

Njohuritë e përfuara në këtë program, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re të Arsimit të Mesëm të Lartë, mundësojnë rritjen dhe forcimin e njohurive të nxënësit jo vetëm në gjuhën italiane, por edhe në lëndët e tjera, si p.sh. në lëndët e historisë, të gjeografisë, të biologjisë etj, duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike. Kjo ndërthurje ndërëndore fiton një dimension të ri në përpjekjen për të siguruar dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Këto dije, gjithashtu, e përgatitin nxënësin për t'u përballur me studime të mëtejshme, si dhe me situata punësimi brenda dhe jashtë vendit.

Mësimi të gjuhës italiane i janë kushtuar 2 orë javore, me një numër të përgjithshëm prej 72 orësh vjetore. Konceptimi i programit të gjuhës italiane për klasën X është përpiluar në mënyrë të tillë që me anë të dijeve që nxënësi merr gjatë procesit mësimor të zhvillojë personalitetin e tij, duke rritur besimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë.

1. SYNIMET

Ashtu siç është paraparë edhe në Kuadrin e Përgjithshëm të Kurrikulës, mësimdhënia / mësimnxënia e GjH e në veçanti e gjuhës italiane bazohet dhe mban parasysh parimet, synimet dhe objektivat që ka përcaktuar shkolla jonë; ato u përgjigjen:

- zhvillimit të një kulture demokratike,
- nevojave dhe interesave individuale të nxënësve,

-bartin gjerësisht përvojën bashkëkohore arsimore në botë.

Me synimin për të përmirësuar në vazhdimësi procesin mësimor janë mbajtur parasysh:

- liria dhe pavarësia e mësuesit,
- nxitja dhe përdorimi i metodave e materialeve mësimore që mbështetin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore të nxënësit, zhvillimin e aftësisë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme,
- konsolidimi i pozitës që nxënësi ka si qendër e procesit mësimor, konsolidimi dhe bashkëveprimi përmes punës në grup,
- nxitja e përdorimit dhe e studimit të materialeve autentike, me burim nga masmedia e shkruar dhe e folur,
- ndërgjegjësimi i nxënësit për identitetin e vet kulturor, nxitja dhe motivimi i tij për ta krahasuar atë me kulturën e vendit fqinj.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Mësimi i gjuhëve të huaja synon t'i ofrojë nxënësit një instrument të përshtatshëm për t'u përdorur në mënyrë të frytshme në fusha të ndryshme të jetës. Në kuadrin e objektivave të ciklit të mesëm të lartë, përmes mësimit të gjuhës së huaj, në veçanti të asaj italiane, synohet arritja e:

- shkathhtësisë me shkrim dhe me gojë;
- saktësisë me shkrim dhe me gojë;
- aftësisë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme,

Ai synon gjithashtu edhe:

- pasqyrimin dhe ndërthurjen e njohurive të gjuhës italiane me lëndët e tjera.

Objektivat detajohen sipas aftësive, linjave dhe nënlinjave. Ato vëzhgohen dhe maten nga mësuesit dhe vetë nxënësit. Përcaktimi i objektivave u jep mundësi nxënësve që të jenë sa më të pavarur gjatë zhvillimit të procesit mësimor.

Realizimi i këtyre objektivave është detyrim për përdoruesit e programit dhe për të gjithë nxënësit.

Mësimi i gjuhës së huaj kërkon që në klasë të kryhen në mënyrë të vazhdueshme veprimtari në grupe, kolektive, si dhe individuale.

3. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE

Linja 1: Komunikimi dhe formimi kulturor

Përshkrimi i linjës. Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën, kjo linjë e mundëson nxënësin të përftojë njohuri gjuhësore të nevojshme për t'u bërë ballë situatave të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor italishtfolës.

Kjo linjë e pajis nxënësin me dije të thjeshtë, të përgjithshme, praktike duke e përgatitur atë për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën italiane.

Orë të sugjeruara – 55 orë.

<p>Nënlinja 1.1</p>	<p>Objektiva</p>
<p>Kultura dhe Komunikimi (30 orë) Në këtë nënlinjë përshkruhen aspekte të jetës së përditshme, ku realizohen objektivat e aftësive të të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit. Nxënësi aftësohet që:</p>	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të ndjekë biseda të thjeshta; ▪ të hamendësojë; ▪ të kuptojë informacione të thjeshta; ▪ të këmbëjë; ▪ të miratojë; ▪ të kundërshtojë; ▪ të përcjellë një informacion të thjeshtë, të kërkuar ; ▪ të shprehë pëlqimet dhe mospëlqimet; ▪ të krahasojë; ▪ të bëjë dallimin; ▪ të klasifikojë; ▪ të shprehë ndërvarjen e veprimeve, fakteve etj. ▪ të tregojë; ▪ të përsërisë; ▪ të ndërveprojë; ▪ të shkruajë; ▪ të hartojë; ▪ të përshkruajë; ▪ të përmbledhë;
<p>Nënlinja 1.2 (25 orë)</p>	<p>Objektiva</p>
<p>Aktet dhe funksionet e Komunikimit Kjo nënlinjë e njih dhe e aftëson nxënësin për rëndësinë e komunikimit. Ajo e pajis atë me gjuhën dhe funksionet e saj për qëllimet ndërvepruese bazë. Nxënësi aftësohet që:</p>	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të miratojë; ▪ të kundërshtojë; ▪ të kërkojë dhe japë leje; ▪ të urojë; ▪ të shprehë keqardhje dhe dëshira; ▪ të falë dhe kërkojë falje; ▪ të nxisë; ▪ të shprehë pëlqime dhe mospëlqime; ▪ të tregojë përvoja të ndryshme; në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, shkollë, mbrëmje, eskursione etj.

Linja 2. Formimi gjuhësor

Përshkrimi i linjës. Kjo linjë e aftëson nxënësin që të përdorë elemente gjuhësore që futen në suazën e nivelit A1. Nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, nxënësi nxitet të ushtrojë strukturat gramatikore të gjuhës italiane, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë e funksional të tyre.

Orë të sugjeruara – 17 orë.

Nënlinja 2.1	Objektiva
<p>Struktura gramatikore (17 orë)</p> <p>Theksi vihet në paraqitjen e njohurive gramatikore reja, në rimarrjen dhe përforcimin e këtyre strukturave gjuhësore-komunikative, si dhe në përdorimin e tyre në situata komunikative në mjedis klase.</p> <p>Vëmendja e përqendruar mbi gjuhën e folur kërkon veprimtari të fokusuar mbi përdorimin praktik të strukturave dhe elementeve komunikativë. Vërejtjet gramatikore do të duhet të bëhen vetëm në vijim të këtij procesi dhe për të forcuar nxënien e strukturave në fjalë. Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe mendimi kritik. Vetëm përmes tekstesh leximi autentike duhet të bëhet paraqitja dhe futja e strukturave dhe/ose e rregullave gramatikore dhe jo si një proces shpjegimi statik tabelash apo rregullash.</p> <p>Strukturat dhe format e parashikuara synojnë të nxiten aftësinë komunikuese të nxënësve duke aktivizuar funksionet minimale. Këto janë elementet më përdorshme që bëjnë të mundur realizimin komunikimit brenda fushës tematike të përzgjedhur</p>	<p>Në përfundim të klasës së 10^{të} nxënësi/ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ të dallojë;▪ të zgjedhojë;▪ të shkruajë;▪ të tregojë;▪ të riprodhojë;▪ të përdorë;▪ të përshkruajë. <p>foljen në kohën e tashme dhe të shkuar, të ardhmen, formën veprorë, ligjëratën e drejtë, format me –ing të foljeve, lidhësat, folje frazale foljet modale, përemrat vetorë, dëftorë, pyetës dhe pronorë, rendin e fjalëve në fjali, mbiemrat format e tyre, ndajfoljet, nyjet, nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme.</p> <p>Format dhe strukturat gramatikore që në for rekomanduese, do të ishin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Suoni e lettere;• Pronomi personal;• Ausiliari “essere” e “avere” in diversi tempi dell’indicativo;• Avverbi diversi;• Il genere; Il numero;• Nomi ed aggettivi; concordanza;• Articoli determinativi e indeterminativi;• Il presente indicativo; coniugazione regolare e irregolare;• Preposizioni semplici e articolate;• Pronomi possessivi, relativi, interrogativi;• Verbi servili o modali;• Il passato prossimo; Il participio passato; Accordo con il soggetto;• Il futuro semplice;• Particelle avverbiali e pronominali “ci” e “vi”; <p>Introduzione di forme verbali sporadiche del condizionale (<i>gradirei, vorrei, ecc.</i>)</p>

Objektivat sipas aftësive gjuhësore

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} të nivelit fillestar nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ të kuptojë mjaftueshëm fraza të shkurtra e të thjeshta në të cilat përmbahet informacion personal, familjar, mbi jetën e përditshme; ✚ të dallojë temën e diskutimit që zhvillohet në prani të tij nëse biseda bëhet ngadalë dhe shqiptimi është normal; ✚ të kuptojë udhëzime të shqiptuara ngadalë; ✚ të ndjekë orientime dhe udhëzime të shkurtra dhe të thjeshta; ✚ të kuptojë dhe të nxjerrë pikën / pikat themelore të një njoftimi, të një mesazhi të thjeshtë e të qartë me temë nga jeta e përditshme personale, shkollore, familjare, e të tilla; ✚ të kuptojë shprehje të përdorimi të përditshëm për të kënaqur nevojat e thjeshta konkrete kur ato janë të formuluar në mënyrë të thjeshtë, konkrete, të drejtpërdrejtë, shpesh me përsëritje, me një shqiptim të ngadaltë dhe të qartë; ✚ të kuptojë udhëzime dhe pyetje që i drejtohen atij me një ritëm të ngadaltë; ✚ të ndjekë këshilla dhe udhëzime të thjeshta e të shkurtra; ✚ të përdorë gjuhën për të kërkuar diçka, për të marrë dhe dhënë leje, për të shprehur një pëlqim, refuzim, ftesë, dëshirë, falenderim, prezantim, përsëritje e të tilla.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} të nivelit fillestar nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ të kuptojë tekste të shkurtra dhe të thjeshta mbi tema konkrete me gjuhë të përditshme; ✚ të kuptojë tekste të shkurtra ku është përdorur një fjalor i thjeshtë, i njohur, duke bërë edhe përsëritje kur është e nevojshme; ✚ të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta në një letër personale, kartolina, sms e të tilla; ✚ të gjejë një informacion specifik e të parashikueshëm në dokumente me përdorim të përditshëm si orare, lajmërimi shkollor, në të cilat përmbahet një fjalor i përditshëm; ✚ të kuptojë dhe ndjekë udhëzime të thjeshta lidhur me përdorimin e një pajisjeje si telefon celular, aparat fotografik e të tilla, në të cilat është përdorur një gjuhë e thjeshtë.
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} të nivelit fillestar nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ të përshkruajë ose të paraqesë në mënyrë të thjeshtë njerëz, kushtet e jetesës, veprimtaritë e përditshme, një dëshirë, me

	<p>shprehje të shkurtra ose fraza të palidhura.</p> <ul style="list-style-type: none"> + të përshkruajë veten, vendin e vet të banimit; + të përshkruajë familjen e vet, punët ose profesionet që anëtarët e familjes bëjnë; + të shpjegojë se përse i pëlqen / nuk i pëlqen diçka; + të përshkruajë dhe të krahasojë shkurtimisht, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë, sende që e rrethojnë ose që i përkasin; + të përshkruajë përvoja vetjake të së shkuarës; + të tregojë një histori të shkurtër, me temë nga jeta e përditshme, shkollore, familjare, e të tilla. + të bëjë një lajmërim të shkurtër publik me një përmbajtje të parashikuar për tema nga jeta shkollore, jeta e përditshme, e të tilla; + të marrë pjesë në një bisedë të shkurtër me tematikë nga jeta e përditshme, shpesh me përsëritje e një ritëm të ngadaltë; + të kërkojë dhe të japë përgjigje për diçka, mbi një temë të përgjithshme, nga jeta e përditshme; + të kërkojë e të përgjigjet për numra, sasi, orën, një porosi për të ngrënë diçka, çmimet, oraret e mësimëve apo të nisjeve të mjeteve të transportit publik, etj; + të flasë për kohën duke përdorur nocione si javët, muajt, ditët, orët, etj; + të kërkojë dhe t'u përgjigjet pyetjeve personale, familjare, shkollore, e të tilla.
Të shkruarit	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} të nivelit fillestar nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> + të shkruajë fjali dhe shprehje të thjeshta e të veçuara; + të shkruajë fraza të thjeshta të lidhura me ndihmën e disa lidhëzave të thjeshta bashkërenduese (për shembull <i>ma, e</i>) dhe nënrenduese (për shembull <i>perché</i>); + të shkruajë fraza të thjeshta mbi veten dhe mbi personazhe imagjinare, çfarë bën / bëjnë, ku jeton / jetojnë; + të shkruajë një numër frazash të thjeshta mbi familjen e vet, kushtet e jetesës, mbi profesionet e anëtarëve të familjes; + të përshkruajë me shkrim, shkurtimisht dhe thjesht, një ngjarje, një veprimtari të tashme e të shkuar nga jeta personale e familjare; + të shkruajë një letër personale të thjeshtë, një kartolinë, një mesazh sms; + të shkruajë data, numra, orët, adresat, moshën, e të tilla.

4. KERKESA NDAJ LENDEVE TE TJERA

Programi i gjuhës italiane për klasën X (për fillestarë) mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore në përgjithësi dhe të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit

e të shkruarit). Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës italiane, e të trajtuara në lëndët e tjera.

Kjo ndërthurje mes *shkencave natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin e shifrave, numrave, veprimeve matematikore (shumëzimi, pjesëtimi, mbledhja e zbritja, thyesat).

Në lëndën e *biologjisë* kjo lidhje reflektohet në trajtimin e linjës “Komunikimi dhe formimi kulturor” kryesisht tek tematika “Bota rreth nesh”, duke trajtuar tema si ambienti, ushqimi, shëndeti, kafshët.

Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën, si pjesë e fushs tematike “Jeta e përditshme”.

Me shkencat sociale janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, festat etj. Pjesë këto të fushës tematike “Jeta personale e shoqërore”.

Trajtimi ndërlëndor i shërben synimeve të përgjithëshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe nënlinjave të tij, kryesisht për:

Edukimin intelektual: Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme nxënësit arrijnë të zbulojnë, analizojnë, sintetizojnë dhe vlerësojnë, duke rritur cilësinë e të nxënës.

Edukimin mjedisor. Ndotja, mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim në vetvete por, në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimin kulturor dhe etik. Përmes lëndëve histori dhe gjeografi, nxënësit fitojnë njohuri, mbi vendin fqinj. Këto njohuri ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtij vendi, zakonet e doket e tij, mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe shprehitë etike të këtij populli. Nxënësit mësohen të ndërveprojnë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, që trajtohen përmes funksioneve gjuhësore si: të kërkojnë falje, sqarime, të pyesin etj.

Edukimin për të drejtat e njeriut. Njohja e kulturës së vendit fqinj trajtohet ngushtë me temat e barazisë sociale, diskriminimit social, respektit reciprok etj.

Atdhedashurinë. Duke njohur kulturën e popullit fqinj nxënësit bëjnë krahasime me kulturën amtare dhe ndërgjegjësohen për identitetin e tyre kombëtar.

5. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i klasës së 10^{të} për nivelin fillestar është një dokument zyrtar, dhe si i tillë ai është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjithë përdoruesit e tij (mësues, nxënës, drejtues të arsimit në shkollat e arsimit të mesëm, inspektorë të gjuhës italiane në drejtoritë arsimore të qytetit e të qarkut).

Për të siguruar përdorimin sa më produktiv të programit është e vlefshme njohja me:

- Synimet e përgjithshme të kurrikulës së AML-së;
- Synimet e linjave ndërkurrikulare;
- Vlerësimin të nxënësve më notë;

- Parimeve të mësimdhënies dhe nxënies;
- Standardet e arritjeve të gjuhës italiane në këtë nivel;
- Programet lëndore.

Orët mësimore

Gjuha italiane për klasën e 10^{të} për nivelin fillestar zhvillohet me 2 orë mësimore në javë dhe shpërndarja e orëve të planifikuara sipas linjave dhe nënlinjave që vijnë njëra pas tjetrës. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës së gjuhës italiane, mbasi sasia e orëve rekomandohet sipas linjave dhe nënlinjave. Por, kjo nuk do të thotë se mësimdhënia e nxënia do të zhvillohet në këtë renditje gjatë gjithë vitit shkollor. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Kjo do të thotë se kur mësues/i, -ja ndeshet me vështirësi të caktuara në përmbushjen e objektivave të kapitullit ai/a jo ngadalëson hapin. Por ai/a mund të ecë më shpejt në realizimin e objektivave, kur vë re se nxënës/it,-et provojnë me shkrim apo me gojë një përvetësim të kënaqshëm në gjuhën italiane.

Afërsisht **70%** e orëve mësimore të përgjithshme në programin e gjuhës italiane për klasën e 10^{të} për nivelin fillestar përdoret për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, dhe **30%** e tyre përdoren për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha italiane për klasën e 10^{të} për nivelin fillestar zhvillohet me 2 orë mësimore në javë (36 javë x 2 orë = 72 orë vjetore).

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) linjat dhe nënlinjat ndërthuren me njëra tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes të shpërndarjes së orëve për sa vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 55 orë, të cilat ndahen sipas nënlinjave që i përgjigjen 30 orë mësimore për *Kulturën dhe komunikimin* (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 21 orë do të jenë për trajtimin e lëndës së re, ndërsa 30% e tyre që përbëjnë 9 orë do të shërbejnë për përpunimin e njohurive: me përpunim do të kuptojmë p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse apo ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 25 orë për *Aktet dhe funksionet e komunikimit* (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 18 orë mësimore që shërbejnë për njohuritë e reja, ndërsa 30% e tyre d.m.th. 7 orë mësimore do të përdoren për përpunimin e njohurive. Në këtë linjë mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës d.m.th. ai jep detyra komplekse ku pasqyrohen njohuritë e përfutuara sipas linjave dhe nënlinjave në një kapitull.)

Formimi gjuhësor zë 17 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 12 orë mësimore për trajtimin e strukturave të reja, ndërsa 30% e tyre që përbëjnë 5 orë do të shërbejnë për rimarjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Realizimi i orëve të përgjithshme (72 orë në vit) është sa i detyrueshëm aq edhe elastik. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar të gjitha orët e planifikuara deri në fund të vitit shkollor, është elastik sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të gjuhës italiane. P.sh. 10% e orëve sipas linjave dhe nënlinjave mësuesit janë të lirë t'i përdorin si brenda një linje për shtesë, ashtu edhe e transferojnë te një linjë tjetër në varësi të nevojave të nxënësve.

Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës italiane për klasën e 10^{te} për nivelin fillestar realizohet përmes linjave dhe nënlinjave që fillon nga nivelin A1. E gjithë lënda përqëndrohet te përmbajtja, që realizohet në fushat tematike, të cilat gjejnë pasqyrim në tema si më poshtë:

“... Shokët dhe shoqëria, Personaliteti, Komuniteti, Udhëtimet, Figurat historike Shkrimtarët, Artistët, Trupi dhe shëndeti, Sportet, Ushqimet dhe ushqyerja, Gjeografia e gjuhës, Mënyra e jetesës, Profesionet, Blerjet e ndryshme, Shpikësit dhe shpikjet, Teknologjia ...”

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda nje kapitulli (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve pararendës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (edhe pse ky integrim do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimi, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e veçantë);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja e nënlinja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar)

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet vëmendje dhe kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si p.sh., të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore, të të menduarit kritik dhe krijues;
- Aftësive të posaçme lëndore si p.sh të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shruarit;
- Formimit të qëndrimeve, si p.sh. qëndrimi etiko-social edhe gjatë punës në grupe të vogla nxënës/ish,-esh.

Gjatë përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë detyra tematike nga jeta e përditëshme, projekte kurrikulare, etj.

Rishqyrtimi vjetor, i cili bën pjesë në përpunimin e lëndës, pikësynon të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet dhe metodat e kësaj lënde.

Programi i klasës së 10^{te} për nivelin fillestar orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës italiane në nivelin A1 +.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/ nxënies për t'ja përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënësit në vijshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj. Zhvillimi dhe përvetësimi i këtyre metodave gjatë mësimdhënies/nxënies i bëjnë nxënës/it,-et të aftë të shprehen me shkrim dhe me gojë ndërmjet njëri tjetrit dhe shokëve e shoqeve të tyre në vendin italishtfolës. Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme sipas aftësive gjuhësore (dëgjimi, të folurit, të lexuarit, të shkruarit) si:

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit.
- Të klasifikojë çështjet që dëgjon.
- Të përqendrohet e të zbulojë detaje të thjeshta.
- Të hamendësojë çfarë flitet në magnetofon.
- Të bëj lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit visual.
- Të dëgjojë një tregim, këngë, etj, disa herë për të kuptuar idenë kryesore duke u përqëndruar në fjalët që njeh.
- Të përqendrohet tek kërkesa e dëgjimit.
- Të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi.
- Të kërkojë ndihmën e bashkëfolësit kur nuk di kuptimin e ndonjë fjale apo shprehjeje..
- Të përdorë shprehje, pauza, gjeste etj., me qëllim që të fitojë kohë në gjetjen e fjalës së duhur.
- Të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëfolësi për t'u siguruar për kuptimin e mesazhit që përcillet.
- Të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.
- Të bëjë bisedë të ndërsjelltë me bashkëbiseduesin.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit si: figura, titulli i mësimit etj.
- Të lexojë tekstin për herë të dytë që të hamendësojë kuptimin e fjalëve të panjohura.
- Të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme.
- Të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke ju rikthyer disa herë leximit.
- Të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar.
- Të planifikojë paragrafët duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf.
- Të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës si: shembuj, sqarime etj.
- Të kontrollojë lidhjen llogjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse.
- Të këmbëjë punën e tij më atë të shokut.

Zbatimi i programi mbështetet në parimet e mëposhtme:

➤ **Vendosjen e nxënësit në qendër të vëmendjes.**

Programi merr parasysh nxënësin, njohuritë e tij, aftësitë e grup-moshës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo reflektohet së pari, në përzgjedhjen e temave që trajtohen, së dyti në përdorimin e strategjive që e nxisin nxënësin të veprojë me gjuhën së treti, në përfshirjen e tij në vlerësimin dhe vetvlerësimin e dijeve të përfuara.

➤ **Krijimin e mjedisit të të nxënës.**

Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, ku nxënësi ndjehet i sigurt, mundëson një mësimdhënie dhe nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuara më parë.

➤ **Organizimin e klasës.**

Mësuesi përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimit mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi apo lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

➤ **Të mësuarin bashkëveprues/kooperues.**

Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e rrjedhshëm dhe zhvillojnë shkathtësi sociale. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon gjithashtu në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

➤ **Përdorimin e gjuhës në klasë.**

Gjuha italiane është mbizotëruese gjatë orës së mësimit. Mësuesi që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës italiane në klasë, minimizon në maksimum përdorimin e gjuhës amtare.

➤ **Të mësuarin e gramatikës.**

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të nxënies, ekspozohen ndaj dukurive të reja gramatikore.

➤ **Qortimin e gabimeve.**

Gabimet duhet të qortohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vërtetërespektin. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e nisativës, heqjen e dëshirës për të folur, demotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimit. Mësuesi ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme qorton më shpesh kur nxënës/it-et praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

Puna e diferencuar me nxënësit.

Më qëllim që metodat e mësimdhënies dhe nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standarteve të përcaktuara mësuesi planifikon punën diferencuese me nxënës/it,-et.

Duhet të pranojmë se niveli i përgatitjes së aftësive të nxënësve që i nënshtrohen programit të gjuhës italiane të klasës së 10^{te} për nivelin fillestar nuk është i njëjtë për të gjithë nxënës/it,-et. Arritja e rezultateve të kërkuara nga programi për të gjithë nxënës/it-et kërkon që mësuesi të marrë para sysh formimin e tyre të ndryshëm të përgjithshëm, kulturor e gjuhësor. Kjo gjë ndodh për arsye objektive apo subjektive. Prandaj, mësuesi planifikon punën e tij të diferencuar në metodën e mësimdhënies, ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor, si dhe format e ndryshme të vlerësimit.

Së pari, mësuesi njihet mirë me përbërjen e klasës së tij dhe me problemet që kanë nxënësit. Mësuesit kanë të bëjnë me adoleshentë dhe për këtë arsye ata ndeshen edhe me shumë probleme të moshës së tyre, si: temperament impulsiv, të ashpër në komunikim, ndonjëherë agresiv, dorëzim para një detyre të dhënë etj.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënësit në mësim mësuesi përdor disa teknika si:

- Të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve.
- Të ndjekë klasën në çdo hap brenda dhe jashtë saj.
- Të ndajë përgjegjësitë atje dhe atëherë kur duhet për çështje vendim-marrje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.
- Të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve.
- Të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.

Nxënës/it,-et kanë nevojë për një siguri profesionale dhe njerëzore në klasë, prandaj mësuesi përdor metoda të larmishme dhe gjithpërfshirëse demokratike, duke siguruar një mjedis të rregullt brenda normave dhe rregullave të shkollës. Më poshtë po japim disa mendime se si mësuesi i nxit nxënës, it,-et të punojnë në klasë dhe jashtë saj:

- Shmang çdo gjë që nuk i përshtatet moshës dhe nivelit të nxënësve.
- Zgjedhja e materialeve për mësim të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor.
- Nëse diçka nuk ecën në klasë mësuesi mënjanon punën në grup për individë të veçantë dhe i ve në punë individuale.
- Përdor ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to.
- Shmang ushtrimet që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë.

- I motivon nxënës/it,et edhe për një detyrë fare të vogël që kanë bërë, me qëllim që të rrisin dëshirën dhe përgjegjësitë për mësimin e gjuhës së huaj.
- Nuk i paragjykon nxënës/it,-et, por përkundrazi u jep ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

VII. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin të mësimnxënies. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk mund t'i vlerësojë nxënësit për objektiva që nuk përmbahen apo nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënësit duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitëse sesa suksesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës.

Mësuesi monitoron, vlerëson detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit që të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

- *Vlerësim i dijeve* (ose i niveleve) ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji, ose semestri, pra puna që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijës është i bazuar në orën e mësimin. Kështu ai i korrespondon një vështrimi të brendshëm.
- *Vlerësim i kapaciteteve* (ose zbatimi i aftësive ose performancës) është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër eksperiencës së nxënësit dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë mëse të dukshme.
- Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: reciton, interpreton, prodhon një ese a shkrim tjetër etj.

Vlerësimin me shkrim dhe me gojë duhet të mbajë parasysh komponentet e mëposhtme:

- *Vlerësimi formues*, me anë të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësi në formimin e tij gjuhësor në përputhje me objektivat e caktuara.
- *Vlerësimi diagnostikues*, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin e materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektshmërinë e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.
- *Vlerësimi i planifikuar* mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.
- *Vlerësimi motivues*, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës italiane. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

- *Vlerësimi përfundimtar* është vlerësimi me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe nënlinjave për këtë grup-moshë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe as të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënësve, tek ato njëorëshe; teste me alternative ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësve, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësve. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon.

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës italiane, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar;

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;

Nxënësi mban shënim arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;

Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënësve të tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmoshën e tyre, dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi.